



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
NJËSIA ADMINISTRATIVE KURVELESH

Nr. 99 Prot

Gusmar, me 20. 10. 2025

LENDË: INFORMACION PER VEPRIMTARINE E NJESISE ADMINISTRATIVE KURVELESH PER PERIUDHEN JANAR-SHTATOR 2025

DREJTUAR: KESHILLIT TE BASHKISE TEPELENE

Per priudhen janar-shtator 2025 puna ne Njesine Administrative Kurvelesh eshte perqendruar kryesisht te sherbimet publike dhe mbledhjen e te ardhurave.

-Persa i perket sherbimeve gjate kesaj periudhe realizimi i objektivave te vena eshte arritur.

Keshtu gjate periudhes mars-prill eshte bere pastrami i te gjitha varrezave publike dhe te deshmoreve qe jane ne territorin e Njesise.

Cdo dite punonjesit e sherbimeve kane qene ne krye te puneve duke bere qe i gjithe territori i Njesise te jete i paster.

-Gjithashtu eshte bere e mundur mbajtja nen kontroll e aksit rrugor Gusmar-Salari pjese e cila eshte nen juridiksionin e Njesise Kurvelesh.

-Persa i perket mbledhjes se te ardhurave pavarsisht bllokimit te levizjes se kafsheve per shkak te semundjes se murtajes, shkak i cili bllokoi lidhjen e kontratave kullosore, plani i te ardhurave eshte ne masen 85% si nente mujor dhe shpresojme qe tani qe eshte bere e mundur shbllokimi i lidhjes se kontratave te realizohet ne masen 100% por gjithmone me mbeshtetjen e Drejtorise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural pa te cilen nuk mund te arrijme objektivin e vendosur.

- Gjate periudhes janar-shtator edhe punonjesit qe sherbejne ne zyrat e Njesise kane qene ne lartesine e detyres duke zgjidhur ne kohe te gjitha problematikat e adresuara ne Njese ose

duke i percjelle ato ne drejtorite perkarkatese ne Bashki ku per hire te te vertetes kemi patur nje bashkepunim shume te te mire.

-Gjate muajit gusht me mbeshtetjen e drejtorise se Arsm-kultures dhe Drejtorise Ekonomike eshte bere e mundur rehabilitimi i te gjitha objekteve arsimore dhe krijimi i kushteve normale per fillimin e mbare te vitit te ri shkollor 2025-2026.

-Keto kane qene ne pergjithesi aktivitetet e punes ne Njesine Administrative Kurvelesh, megjithate jemi te hapur per cdo vrejtje apo keshill nga ana e Juaj si keshilltar te Keshillit Bashkiak Tepelene.

-Faleminderi per mirekuptimin Tuaj.



ADMINISTRATORI

Shaban LOCI